Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0889

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga XX duke vendosur sipas ankesës së OE "PBC Sh.P.K" kundër Njoftimit për anulimin lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 19/01/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "PBC Sh.P.K" me nr. 2023/0889 , e datës 02/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.02.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1. Ndërsa me datën 25.10.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,080,000.00 €.

Me 30.10.2023, OE "PBC Sh.P.K"ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "PBC Sh.P.K" me nr. 889/23 lidhur me aktivitetin" Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PBC Sh.P.K", janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I): "Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 51, nenin 52, paragrafin 3 të nenit 56 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurim Publik në fuqi dhe nenin 25.5, 40.2 dhe 40.12 të Rregullores nr. 01/22 për Prokurim Publik, sepse: Gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka ndryshuar dhe ka shtuar kritere të përzgjedhjes dhe ka diskualifikuar tenderin tonë për kërkesa që nuk kanë qenë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Provat: Në Dosjen e Tenderit (Prova 1), sqarimet shtesë (Prova 2) dhe në Njoftimin për Kontratë përmes Formularit B54 Autoriteti Kontraktues (Prova 3) ka kërkuar që certifikimet e stafit pranohen nga Institucione të akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit, mirëpo të njëjtat nuk i ka pranuar përkundër që PBC Academy është e akredituar nga Agjencia Kombëtare e Kualifikimeve (Prova 4) dhe e Licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Prova 5). Në refuzimin e Kërkesës për Shqyrtim të Vendimit, Autoriteti Kontraktues refuzimin e certifikimeve e ka arsyetuar me "Sa i përket pretendimit rreth sqarimeve ne fazën e tenderimit se: "Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara /licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës" -- kjo nuk e arsyeton pretendimin tuaj, meqenëse kjo nuk nënkupton se lejohen certifikatat për lami jashtë fushës se akreditimit dhe as certifikata te pa akredituara." dhe b) "Certifikatat e ofruara nga ana juaj nuk kane date te lëshimit e as validitet, si shembull e bashkëngjisim një të tillë në vijim, ku përveç vulës se noterisë, mungon data e lëshimit, validiteti, dhe verifikimi nga AKK". Një veprim i tillë, përveç se esencialisht ndryshon kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë (par. 3 i nenit 56 të LPP dhe neni 40.2 i RrPP) është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 51 të LPP dhe nenin 25.5 të Rregullores për Prokurim Publik, ku thuhet "Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar." Pra, kërkohet që kriteret e përzgjedhjes duhet të definohen qartë e JO të nënkuptohen, shtohen ose ndryshohen! Thënë ndryshe,

Autoriteti Kontraktues kërkesën (kriterin e përzgjedhjes) për certifikime nga institucione të akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e ndryshon në certifikime të verifikuara nga Agjencia Kombëtare e Kualifikimeve, respektivisht gjatë ekzaminimit, vlerësimit, dhe krahasimit të tenderëve, kërkesën (të shprehur qartë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë) e largon të tërën si kriter të përzgjedhjes dhe e ndryshon, përkatësisht e shton kriterin "Certifikata të akredituara/validuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve). Ndërsa tek pika b, e "zbulon një mos-përputhshmëri" në strukturë dhe përmbajtje e cila, po ashtu fare nuk ishte kërkesë. Kësi soji, pretendon ta kontestoj vërtetësinë e certifikimeve, pa marrë mundin ti verifikojë ato tek autori i tyre (PBC Academy) ose pa marrë në konsideratë provat e jashtme, siç është dokumentari i RTK, të cilin e gjeni në këtë shteg: https://youtu.be/wdxHB337Fvs?si=o46wb0ONF5B_ogm E për të cilët, PBC Academy ka lëshuar certifikata, sikur edhe lejohet nga Agjencia Kombëtare e Kualifikimeve (Prova 6). 2. Autoriteti Kontraktues, me mashtrim dhe duke na vënë në lajthitje ka ndryshuar kriterin për dhënie të kontratës nga "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" (neni 52 dhe 60 i LPP) në një kriter që nuk është fare në legjislacionin për Prokurim Publik, por që ata e kanë emëruar "Tregues shtesë për nevojën e anulimit te AP është edhe aspekti financiar, bazuar ne paragrafin 1 i nenit 1 te LPP-se, ne lidhje me dallimin e madh ne çmim prej 531,251.69 euro, ne mes ofertës tuaj 1,064,375.69 euro dhe ofertës tjetër pretenduese 533,124.00 euro." duke: a)anashkaluar tërësisht faktin që vlera e parashikuar për kontratë (neni 17 i LPP dhe neni 13 i RrPP), sipas vlerësimit të Autoritetit Kontraktues ka qenë 1,070,000.00 euro. Pra më shumë sesa çmimi që ne kemi ofruar, b)krahasuar ofertën tonë financiare me çmimin e operatorit ekonomik të cilin vetë e kanë eliminuar edhe me arsyetimin që nuk i ka përfshirë rreth 2/3 të kërkesave të dosjes së tenderit, c) mos marrë fare në konsideratë çmimin e pagave për inxhinierët e kërkuar, numrin dhe kohëzgjatjen e angazhimit të tyre në projekt dhe kostot përcjellëse. 3. Operatori Ekonomik BOTEK nuk ka përvojën e kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga shkresat e lëndës që përmbajnë ekspertizë të ekspertit të Bankës Botërore, njëkohësisht arkitekt i Sistemit Informativ të Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë. Përveç kësaj, kjo kompani fare nuk ka qenë zhvilluese e Recetës Elektronike, për të cilën pretendon se është e ngjashme me Sistemin Informativ Shëndetësor. Nga gjendja dhe provat e mësipërme shihet qartë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur rëndë dispozitat ligjore dhe kanë rënë ndesh me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, për çka, me date 7 nëntor 23 i kemi kallëzuar penalisht në Prokurorinë e Shtetit. Ndërsa nga OSHP kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe Autoriteti Kontraktues ti respektojë dispozitat ligjore."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 51, 52, 56 paragrafi 3 dhe nenin 60 të LPP –së si dhe Nenin 25.5, 40.2, 40.12 të Rregullores nr. 01/22 për Prokurim Publik dhenenin 8, nenin 21, 22, 28, 278, 323 dhe 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 (KPRK). Duke propozuar që OSHP që lënda të kthehet në rivlerësim dhe Autoriteti Kontraktues ti respektojë dispozitat ligjore.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: "AK-MSh qëndron prapa Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 25.10.2023, ku oferta juaj është trajtuar si e papërgjegjshme për arsyet e cekura ne 1342

Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe qe ky aktivitet te anulohet për mungese te ofertave te përgjegjshme.Tregues shtesë për nevojën e anulimit te AP është edhe aspekti financiar, bazuar ne paragrafin 1 i nenit 1 te LPP-se, ne lidhje me dallimin e madh ne çmim prej 531,251.69 euro, ne mes ofertës tuaj 1,064,375.69 euro dhe ofertës tjetër pretenduese 533,124.00 euro.Sa i përket pajtueshmërisë tuaj me konstatimin e ekspertit te huaj qe HIFIS dhe HIS janë dy sisteme të ndryshme, nuk kemi çfarë te shtojmë në këtë çështje, pasi qe për këtë çështje gjate rivlerësimit kemi kërkuar opinion ligjor te Departamenti Ligjor i MSh-se dhe prej tyre kemi pranuar përgjigjen me shkrim me nr. protokolli 05-6593/2 të datës 24.10.2023, ku është sqaruar se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore nuk i takon ndonjërit nga nivelet e shëndetësisë, siç është kërkuar ne kriterin e NJK dhe DT.Sa i përket pretendimit nr. 2, ne lidhje me diskualifikimin e ofertës tuaj si dhe pretendimit për shkelje te paragrafit të nenit 7 të LPP-së, ne nuk pajtohemi me këtë pretendim dhe konsiderojmë se i kemi trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, si dhe kemi vepruar në mënyrë transparente.Bazë për Ri-vlerësimin e aktivitetit ka qene Vendimi i OSHP-se nr. 282/23 i datës 13.09.2023, i cili ka qene mjaft i qarte dhe nder te tjera PSH ka kërkuar qe: mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së që të vlerësojë dhe ekzaminojë ofertat konform dispozitave të LPP-së në relacion me pretendimet ankimore të OE ankues. Sa i përket pretendimit rreth certifikatave te lëshuara nga PBC Akademy, konsiderojmë se sqarimi i dhënë me shkrim nga Autoriteti Kombëtar te Kualifikimeve, me email për ekspertin shqyrtues, është mjaft i qarte se Kandidatet e certifikuar qe i keni bashkangjitur nuk i kanë certifikatat e verifikuara nga AKK duhet ta keni parasysh qe çdo kandidat i certifikuar duhet ta këtë certifikatën e verifikuar nga AKK. Ekspertet shqyrtues kane verifikuar validitetin e certifikatave te ofertës tuaj, ku janë sqaruar edhe me Autoritetin Kombëtar te Kualifikimeve (AKK), përshkrimi si ne vijim: Megjithatë, ka dyshime lidhur me validitetin e certifikatave nga OE ankues, duke pretenduar se certifikatat e ofruara nga OE e rekomanduar për kontrate nuk përmbushin ketë kusht, pasi nuk kanë kredibilitet për shkak të mungesës së datës së lëshimit dhe të dhënave që duhet te posedojë një certifikatë të tillë e lëshuar nga institucionet vendore konform ligjit në fuqi, institucioni që lëshon çfarëdo Iloj certifikate do te duhej te jete i akredituar për atë program. Për të sqaruar këtë çështje kam kontakte zyrtarisht me Autoritetin Kombëtar të Akreditimit, duke ju drejtuar atyre me anë te emalit pyetjeve si në vijim: Siç mund te shihet, nga komentet e dhëna nga AKK, lidhur me certifikatat te cilat ju i keni prezantuar ne DT, pasi ato nuk kanë vulën e AKK, bazuar ne përgjigjen zyrtare te pranuar nga AKK-ja, ato nuk janë valide dhe si te tilla nuk e plotëson kriterin sipas DT. Ne baze te sqarimeve te dhëna nga AKK, shihet se certifikatat e ofruara nga ana juaj, nuk janë te verifikuara nga AKK, bazuar ne web faqen e AKK, ne linkun: https://akkks.rks gov.net/Documents?idType=1024 , te Lista e Institucioneve te akredituara, dëshmohet se PBC Academy është e akredituar për lëshimin e certifikatave vetëm si zhvillues i softuerit : "28 PBC Academy Prishtinë Zhvillues i softuerit 124 10/1/2022 - 9/30/2025". Sa i përket pretendimit rreth sqarimeve ne fazën e tenderimit se: "Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës" — kjo nuk e arsyeton pretendimin tuaj, meqenëse kjo nuk nënkupton se lejohen certifikatat për lami jashtë fushës se akreditimit dhe as certifikata te pa akredituara. Certifikatat e ofruara nga ana juaj nuk kane date te lëshimit e as validitet, si shembull e bashkëngjisim një te tille ne vijim, ku

përveç vulës se noterisë, mungon data e lëshimit, validiteti, dhe verifikimi nga AKK. Si përfundim, ne si AK qëndrojmë prapa Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 25.10.2023, qe ky aktivitet te anulohet për mungese te ofertave te përgjegjshme. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane me lart ka vendosur si ne dispozitiv."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.11.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0889/23, ndërsa me datë 06.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/0889 me rekomandimet si në vijim: Sqarim: Për aktivitetin e njejtë te prokurimit është bërë ankesë edhe nga operatori tjetër ekonomik pjesëmarrës ne këte aktivitet te prokurimit dhe kemi edhe raportin e ekspertit shqyrtues nr 2023/0898 te dt.27.11.2023 (ka rekomanduar qe lënda te kthehet ne rivlerësim) ne mënyrë qe te mos krijojmë paqartësi dhe te mos nxjerrim rekomandime vetëm nga aspekti i shqyrtimit të kësaj ankese sepse një vendim final për rrjedhën e aktivitetit te prokurimit mund te merret vetëm pas trajtimit te përbashkët te këtyre dy ankesave . Rekomandimi ynë i poshtshënuar ka te bëje vetëm me ankesën e operatorit ekonomik ankues PBC SHPK nr.2023/0889. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues PBC SHPK është e **PA BAZUAR.**

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Nuk Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "PBC Sh.P.K"eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0889 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): "Sipas pretendimit ankimor nr 1 AK-Ministria e Shëndetësisë ka shkelur nenin 51, nenin 52, paragrafin 3 të nenit 56 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurim Publik në fuqi dhe nenin 25.5, 40.2 dhe 40.12 të Rregullores nr. 01/22 për Prokurim Publik, sepse: Gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka ndryshuar dhe ka shtuar kritere të përzgjedhjes dhe ka diskualifikuar tenderin tonë për kërkesa që nuk kanë qenë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Në refuzimin e Kërkesës për Shqyrtim të Vendimit, Autoriteti Kontraktues refuzimin e certifikimeve e ka arsyetuar me "Sa i përket pretendimit rreth sqarimeve ne fazën e tenderimit se: "Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e

akredituara /licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës" - kjo nuk e arsyeton pretendimin tuaj, meqenëse kjo nuk nënkupton se lejohen certifikatat për lami jashta fushës se akreditimit dhe as certifikata te pa akredituara." dhe b) "Certifikatat e ofruara nga ana juaj nuk kane date te lëshimit e as validitet, si shembull e bashkëngjisim një të tillë në vijim, ku përveç vulës se noterisë, mungon data e lëshimit, validiteti, dhe verifikimi nga AKK. Sa i përket këtij pretendimi ankimor i cili është trajtuar edhe nga ekspertet shqyrtues përmes raportit te ekspertizës nr 2023/0282 te dt. 12.07.2023 dhe sipas te cilit raport edhe AK-MSH ka vendosur ne fazën e rivlerësimit te ofertave, ekspertet shqyrtues ne raportin nr. 2023/0282 kanë paraqitur komunikimet e tyre me Autoritetin Kombëtar te Kualifikimeve (AKK), ku sipas komunikimit ne mes te eksperteve shqyrtues dhe Autoritetit kombëtar te Kualifikimeve AKK rezulton se certifikatat e prezantuara nga PBC SHPK ne dosje te tenderit sipas përgjigjes zyrtare te pranuar nga AKK-ja certifikatat e lëshuara nga OE PBC për kandidatet e certifikuar nuk i kanë certifikatat e verifikuar nga AKK dhe sipas AKK çdo kandidat i certifikuar duhet te ketë certifikatën e verifikuar nga AKK. Bazuar ne raportin e eksperteve shqyrtues nr. 2023/0282, komunikimet e tyre me Autoritetin kombëtar te Kualifikimeve, shkresat e lëndes , raportit te rivlerësimit, konstatojmë se ky pretendim ankimor është i Pa Bazuar."

*Konstatimi i dytë (II)**:** "Sipas OE ankues Autoriteti Kontraktues, me mashtrim dhe duke na vënë në lajthitje ka ndryshuar kriterin për dhënie të kontratës nga "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" (neni 52 dhe 60 i LPP) në një kriter që nuk është fare në legjislacionin për Prokurim Publik. Konstatojmë se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se AK-MSH, operatorin ekonomik ankues ne ketë rast e ka shpallur se pari operator te pa përgjegjshëm ne aspektin tekniko/profesional, për arsyet e cekura tek pretendimi ankimor nr. 1. Po ashtu aspekti financiar trajtohet edhe me nenin 6 te LPP-se Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, citat neni: "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara qete sigurojnë që fondet publik edhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, një kohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndë ne prokurimit ". Çdo autoritet kontraktues gjatë fazës se vlerësimit ne mbështetje te nenit 6 te LPP-së duhet te ketë për bazë aspektin financiar te ofertave dhe trajtimin e tyre ne harmoni me ketë dispozitë ligjore te LPP-së. Bazuar ne sqarimet e lartcekura, shkresat e lendes, raportit te rivlerësimit te përgatitur nga AK-MSH, konstatojmë se ky pretendim ankimor është i Pa Bazuar."*

*Konstatimi i tretë (III)**:** Sipas pretendimit ankimor nr. 3, Operatori Ekonomik BOTEK nuk ka përvojën e kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga shkresat e lëndës që përmbajnë ekspertizë të ekspertit të Bankës Botërore, njëkohësisht arkitekt i Sistemit. Eksperti shqyrtues, duke pasur parasysh ketë pretendim ankimorë si dhe bazuar për qeshjen dhe palët e njëjta është nxjerrur një vendim nga PSH.OSHP me datën 13.09.2023 me nr. 2023/0282, ne bazë te Rregullores Nr.01/2020 te Organit Shqyrtues te Prokurimit, Nenin 16 (Rastet e unifikuar) paragrafi 2 dhe 3 që citohët: Në rastet e përsëritur me pretendimet te njëjta ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjtat për rastet te cilat janë shqyrtuar edhe më parë duhet që të trajtohen si qeshje të gjykuara ,,res judikata" në kuptim te Nenit 105 paragrafit 2.16 te LPP-së. Bazuar ne sqarimet e lartcekura, shkresat e lëndes, kërkesat e dosjes se tenderit, raportit te ekspertizës nr. 0282 te dt., 12.07.2023, vendimit te OSHP nr. 2023/0282 te dt. 13.09.2023, konstatojmë se ankesa e operatorit ekonomik PBC ShPK është e Pa Bazuar.*

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast. Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues, duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues.

Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës i përmban të gjitha pohimet ankimore, dhe është i hartuar në mënyrë profesionale, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel. Andaj, raporti i ekspertizës në këtë rast gjenë mbështetje nga ana e këtij paneli shqyrtues.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka pasur edhe një vendim paraprak të OSHP-së Nr.2023/0282, i datës 13.09.2023. Po ashtu, krahas trajtimi të kësaj ankesë është trajtuar edhe ankesa tjetër me Nr. 2023/0898, për të cilën është marrë vendim që aktiviteti i prokurimit të anulohet në tërësi.

Andaj, paneli shqyrtues duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe vështirësinë e vendosjes meritore në kontekstin e konstatimit të ndonjë nga OE si të përgjegjshëm dhe me të gjitha këto dyshime dhe kundër argumenteve/provave të paraqitura nga të gjitha palët në procedurë, si dhe diferencës së madhe në çmim, erdhi në përfundim se vendosja më e drejtë lidhur me këtë procedurë është anulimi i saj dhe AK në rast se të njëjtën e ka në plan ta ri-tenderoj atëherë të ketë kujdes në vendosjen e kritereve si dhe në rast të ndonjë kërkese e cila nuk është sqaruar mjaftueshëm atëherë gjitha palët që janë të interesuara të ofertojnë të kërkojnë edhe sqarime shtesë në fazën e para aplikimit në tender. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të

jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- OE - **PBC SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: